



PYETJE TË SHPESHTA MBI THIRRJEN PUBLIKE NR.II PËR PROJEKTPROPOZIME, DREJTUAR ORGANIZATAVE RINORE DHE PËR TË RINJTË.

1- A mund të aplikojnë organizatat e krijuara këtë vit në Thirrjen Nr. 2?

Po, por do të aplikojnë si Organizata Rinore duke plotësuar kushtin ligjor që 70% të anëtarëve të jenë të rinj ose të jenë në partneritet me organizata të tjera që plotësojnë kushtet ligjore për aplikim.

2- Cilat organizata konsiderohen Organizata për të Rinj dhe cilat organizata janë Organizata Rinore?

Duke ju referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 75/2019 “Për rininë”, Organizatat për të Rinj janë organizata që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre veprimtari rinore si dhe kanë zbatuar për një periudhë të paktën 3-vjecare, në mënyrë të vazhdueshme, projekte e programe me impakt tek të rinjtë. Organizatat Rinore janë organizata që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre veprimtari rinore dhe 70% të anëtarëve janë të rinj.

3- Vërtetimi që tregon se përfaqësuesi ligjor i organizatës nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë, merret në gjykatë apo në e-albania (vërtetimi i gjendjes gyqësore/dëshmia e penaltetit)?

Është i vlefshëm vërtetimi i lëshuar nga gjykata dhe ai i gjeneruar nga e-albania.

4- A mund të aplikojë e njëjta organizatë një herë si organizatë udhëheqëse dhe njëherë si partner në këtë Thirrje?

Po, një organizatë mund të dërgojë më shumë se një aplikim, njëher si organizatë udhëheqëse (ose aplikues i vetëm) dhe njëher si partner në këtë Thirrje.

5- Në kushtet kur do të aplikohet me një organizatë partnere, duhet që të dyja organizatat të kenë zbatuar tre projekte në fushën e rinisë?

Në këto raste, mjafton që një nga organizatat të ketë zbatuar për një periudhë të paktën 3-vjecare projekte e programe me impakt tek të rinjtë.

6- Deklarata e konfliktit të interesit, nënshkruhet vetëm nga përfaqësuesi ligjor i organizatës?

Deklarata e konfliktit të interesit nënshkruhet nga:

- anëtar të bordit drejtues të organizatës;
- anëtar të asamblesë apo organeve të tjera vendimmarrëse të organizatës;
- drejtues apo punonjës i organizatës.

7- A përfshihen trajnerët dhe mentorët në kostot administrative të projektit?

Jo, trajnerët dhe mentorët përfshihen në kostot e projektit (aktivitetet). Shuma e lejuar e kostove administrative është 30% e vlerës së projektit dhe përfshihen zëra që shërbejnë për menaxhimin e projektit.

8- A duhet të dorëzohet dokumentacioni shtesë edhe nga organizata partnere?

Dokumentet kryesore të paketës së aplikimit (shtojca 7 – shtojca 10) plotësohen nga organizata udhëheqëse. Dokumente shtesë (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse sipas përcaktimit në seksionin 8 të Shtojcës Nr. 6 të thirrjes, duhet të dorëzohet i plotë si nga organizata udhëheqëse edhe nga organizata partnere. Deklarata e partneritetit dorëzohet vetëm një dokument me paketën e aplikimit (në tre kopje fizike dhe një e skanuar në USB).